

# KOMENTE NE DRAFT-DOKUMENTIN STRATEGJIA PËR KALIM NË TRANSMETIM DIGJITAL TOKËSOR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Ne vemandje te

- Komisionit te Pavarur per Media;
- Komisionit Parlamentar per Media;
- Zyres ligjore te Kryeministrat;
- Përfaqësuesit Special te Bashkimit European në Kosovë



23 Janar 2015

**Televizioni Rrokum dhe Televizioni Klan Kosova,**

- duke pershendetur punen e Komisionit te Pavarur per Media ne perpilimin e Strategjise per kalimin ne transmetim digital;
- duke e pare procesin e digitalizimit si nje avansim ne sektorin e telekomunikimeve ne Kosove;
- duke pritur qe digitalizimi ne Kosove do te jete nje momentum i rendesishem qe Kosova gjeneralisht te ndertoje kushte themelore per kompetititet te lire dhe trajtim te barabarte te aktereve te tregut medial;
- duke shpresuar qe ky proces do t'i jap fund qendrimit te disekulibruar dhe asimetrik te KPM dhe legjislacionit aktual, ndaj aktereve te tregut mediatik ne Kosove;
- duke shpresuar qe ky proces do ndihmoje qe industria mediatike ne Kosove dhe institucioni rregullator KPM t'i permbushin direktivat europiane ne kete lami;

vlereson:

a) draft-dokumenti i propozuar "**STRATEGJIA PËR KALIM NË TRANSMETIM DIGJITAL TOKËSOR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**", qe ne krye prezentohej si nje *continuum* i gjendjes aktuale 15 vjeçare ne kete lami, e cila karakterizohet me qendrim krejtësisht te disekulibruar e asimetrik ndaj aktereve te tregut medial ne Kosove, ku tri projekte te trasheguara nga koha e UNMIK (RTK, RTV21 dhe KTV), ende trajtohen ne menyre preferenciale nga ana e KPM, duke implikuar Ligjin Nr. 02/L-15 dhe Ligji Nr. 04/L-44; Direktivën e AVMS; iniciativen europiane ne kete sektor te njohur si 'i2010: European Information Society'; Ligjin per Mbrojtjen e Konkurencës (Neni 4 deri 10); Kushtetuten e Kosovës (Neni 7, 10 dhe 21);

b) dokumenti nuk ofron pritet e industrise mediatike ne Kosove qe kjo gjendje e nje 'fataliteti' teknik te trasheguar nga ish Jugosllavia dhe nga UNMIK, me procesin e digitalizimit te ndryshoje radikalish, duke bere qe Kosova me ne fund te fitoje nje treg virulent mediatik, me aktere te trajtuar ligjisht ne menyre te barabarte;

c) dokumenti nuk merr parasysh shkeljet ligjore qe jane dorezuar ne forme te shkruar nga ana e Televizonit Rrokum ne vitin 2012 ne KPM (shih dokumentin "Si perfunduan dy frekuencia televizive kombetare ne duart e dy familjeve kosovare"), me te cilat vertetohet saktësisht, mes tjerash, fakti diskreditues per KPM dhe krejt legjislaturen kosovare:

**- se pasunia kombetare e Kosovës - dy frekuencia televizive kombetare te Kosovës - KURRE NUK JANE TENDERUAR - ashtu si e determinonte Ligji Nr. 02/L-15, dhe Ligji aktual per KPM;**

ç) dokumenti e hesht ekzistencen e dokumentit te njohur nga viti 2003, "Moratorium", i cili vendoste ndalese ne dhenien e frekuencave lokale televizive per kryeqytetin Prishtina, per te mos krijuar konkurence shtese ndaj projekteve ekzistuese RTK, RTV21 dhe KTV;

- d) dokumenti hesht konfliktin e paster te interesit kur RTK, RTV21 dhe KTV behen bartesit e vetem te akcioneve te Rrjetit Transmetues Terrestrial te Kosoves, duke shkelur ne menyre drastike sot Ligin per Mbrojtjen e Konkurencës dhe vete misionin e KPM si regullatori dhe garantuesi i kompetititetit te aktereve te tregut mediatik;
- dh) dokumenti hesht dhe nuk e vlereson avansimin teknologjik, programor dhe kompetitiv qe solli Televizioni Kabllor dhe operatoret kabllor ne vitin 2006/7, si dhe Internet Televizioni dhe IPTV ne Kosove ne vitin 2013;
- e) dokumenti hesht dhe nuk e konstaton qendrimin asimetrik, preferencial dhe te disekuilibert ndaj aktereve mediatik ne Kosoven e pasluftes dhe na jep nje pasqyre te thyer, te munguar te realitetit mediatik sot.

## KOMENTE DHE SUGJERIME:

Televizioni Rrokum dhe Televizioni Klan Kosova,

gjejne:

1.

Faqja 5, kapitulli "Perkufizimet", dokumenti sjell kete perkufizim per Televizionin Nacional:

*"Televizion nacional – është shërbimi medial audiovizual i licencuar nga KPM i cili përmes rrjetit frekuencor të koordinuar në pajtim me planin frekuencor të Republikës së Kosovës për transmetim tokësorë, mbulon me sinjal radio televiziv mbi 90% të popullsisë së Republikës së Kosovës."*

KOMENT: Burimi i gjithe asimetriqe dhe qasjes diskriminuese qe ndoqi KPM gjate gjithe ketyre viteve eshte pikërisht kuptimi i manget dhe spjegimi i njeanshem se çka nenkuptohet me "Televizion Nacional". KPM ka një kuptim reduktionist se çka duhet kualifikuar si Televizion Nacional. Ajo qe e percakton kuptimin 'nacional' te një mediumi, nuk eshte menyra e bartjes se sinjalit, siç e keqkupon dhe keqinterpretion KPM, por - **territori qe mbulon ai medium me program**. Se programi i ofruar nga mediumet bartet me frekuencë ajrore, me kabell koaksial apo optik, me sinjal satelitor apo telefonik, kjo nuk konteston identitetin e një mediumi si 'nacional' - gjithnjë derisa sinjali i tyre mbulon territorin e krejt Kosoves.

Te kualifikosh si 'nacional', vetem televisionet qe bartjen e bejne permes frekuencies ajrore, eshte njesoj sikur 'molla' t'i konsiderosh vetem ato qe jane te kuqe (sic!).

Ky keqkuptim fundamental qe nuk gjene baze ligjore ne asnjë legjislacion pozitiv europian, eshte edhe keqkuptimi epifokal qe gjeneron qasje diskriminuese te KPM ndaj aktereve te industrise mediatike ne Kosove per gjithe keto vite, duke ra ndesh me legjislacionin pozitiv ne Kosove qe flet per mosdiskriminimin, me Direktiven europiane AVMS qe fton rregullatoret te jene sa me fleksibel per te mundesuar kompetititetin dhe diversitetin e tregut mediatik.

Duke dashur qe te evitohet qasja diskriminuese dhe te pasurohet pershkrimi i sakte i realitetit transmetues qe mundohet te perfshije ky perkufizim,

### SUGJEROJME:

*"Televizion nacional – është shërbimi medial audiovizual i licencuar nga KPM i cili mbulon mbi 80% të territorit dhe popullsisë së Republikës së Kosovës - përmes rrjetit frekuencor të koordinuar në pajtim me planin frekuencor të Republikës së Kosovës për transmetim tokësor; permes operatoreve kabllore te licencuar nga KPM qe mbulojne mbi 80 perqind te territorit; permes sinjalit satelitor e telefonik; permes IPTV platformave."*

## SQARIM:

Perkufizimi qe jep dokumenti duhet te veje theksin mbi "territorin" e jo mbi "mjetin" (teknologjine) me te cilin bartet sinjali. "Mjetet" me te cilat bartet sinjali prej pikes A deri te pika B, nuk do duhej te determinojne 'fatalisht' akteret e tregut, duke i diskriminuar 'teknologjikisht'. Bile ne kuptim teknologjik, avansim sot konsiderohet televizioni kabllor, IPTV platforma, televizioni satelitor, televizioni mobil, e jo televizioni tradicional. Televizioni me frekuence ajrore edhe ne kete kuptim te cunguar qe na e sjell KPM, eshte diçka klasike, e tejkaluar. Andaj, te reduktosh kuptimin e "televizionit nacional" ne menyren se si e barte sinjalin, mendojme se eshte anakronik dhe jo i sakte.

Perkufizimi qe sugjerojme mendojme se sjell nje pershkrim me te sakte te realitetit difuziv sot ne Kosove dhe ofron mundesi me te medhaja kompetititeti. Sugjerojme qe KPM te koncentrohet jo ne reduktimin e kuptimit 'nacional' permes 'mjeteve' me te cilat kryhet bartja e sinjalit per te kualifikuar ose diskualifikuar akteret mediatik, po **ne politiken e taksave dhe ne mbulueshmerine e territorit si determinues per kualifikimet e aktereve mediatik si 'nacional', 'regional' e 'lokal'**.

**Taksat dhe mbulueshmeria territoriale duhet determinuar kualifikimin 'nacional', e jo menyra e derisotme me te cilen ka operuar KPM.**

2.

Faqja 8, kapitulli "**SEKTORI MEDIAL NË KOSOVË**, Kanalet televizive me transmetim tokësor"

Perpiluesi i dokumentit ne kete kapitull, vetmesa verteton te gjitha konstatimet e sjellura ne keto komente tona per qasjen asimetrike dhe diskriminuese ndaj aktereve mediatik ne Kosove.

Ja edhe empiria e ketij diskriminimi:

a) Kapitulli qe i kushtohet kanaleve televizive me transmetim tokesor ka - **1074 fjalë**; ndersa pjesa qe ky dokument ja kushton mediave qe ne deminutiv i diskualifikon duke i quajtur "Ofrues te Sherbimeve Programore", vetem - **90 fjalë** (sic!).

b) Diskriminimi tjeter konsiston ne mospermendjen e emrave te krejt aktereve mediatik. Kapitulli per 'televizonet tokesore' na sjell taksativisht emrat e aktereve (KTV permendet 7 here ne dokument), derisa nuk sjell emrat e televizioneve kabllore qe sot i jepin kuptim tregut medial ne Kosove (RROKUM dhe KLAN KOSOVA nuk permendet ne dokument - asnjeherë!).

**KOMENT:** Keta kapituj jane edhe nje deshmi flagrante e qendrimit diskrimues qe gjenerohet nga keqkuptimet dhe keqinterpretimet qe KPM sjell per t'i perkufizuar akteret mediatik ne Kosove. E kualifikojme si 'deminutiv' perkufizimin 'Ofruesit e Sherbimeve Programore', sepse ky perkufizim ka linde

ne momentin kur Kosova ne vitin 2006 fiton per here te pare ate qe quhet Televizion Kabllor, por per t'i ikur idese se Kosova ka televizione tjera pos RTK, TV21 dhe KTV, Komisioni i Pavarur per Media u percaktu per perkufizim "Ofrues te Sherbimeve Programore" ne rregulloret e saj, duke zvogluar domethenien dhe duke minimizuar vleren qe keto televizione i sollen tregut mediatik ne vitin 2006/2007. Me arsyet qe e linden dokumentin "Moratorium" ne vitin 2003, me te cilin KPM kishte vendose moratorium mbi dhenien e licencave lokale ne kryeqytet, duhet spjeguar edhe deminutivin "Ofrues te Sherbimeve Programore" - per t'i ikur me çdo kusht kualifikimit si 'televizione'. Jo se perkufizimi OSHP nuk eshte i sakte, por ne kontekstin ne te cilin KPM vendosi per t'i quajtur keshtu, e bejne kete perkufizim miniskul e qellimkeq.

SUGJEROJME:

- a) Njesoj, me 1000 fjale, te pershkruhet pjesa qe i kushtohet Ofruesve te Sherbimeve Programore;
- b) Perkufizimi OSHP duhet nderruar dhe duhet perkufizuar si "Televizonet Kabllore". (Shih definimin enciklopedik te Televizionit Kabllor:  
**"Cable television** is a system of delivering television programming to paying subscribers via radio frequency (RF) signals transmitted through coaxial cables or light pulses through fiber-optic cables. This contrasts with traditional terrestrial television, in which the television signal is transmitted over the air by radio waves and received by a television antenna attached to the television.");  
Mendojme se definimi si Televizion Kabllor pershkruen shume me sakte ate qe televizonet si Rrokum dhe Klan Kosova sot e bejne ne aspektin e transmetimit.
- c) Ne kete pjese te dokumentit ne faqen 11, duhet deri ne 1000 fjale te sjellet historia e lindjes se Televizionit Kabllor ne Kosove;
- ç) Taksativisht te numerohen, njesoj si televizonet tokesore, cilat jane televizonet kabllore ne Kosove; cili konsiderohet televizioni i pare kabllor ne Kosove; kur ka filluar me transmetim; permes cilit operator kabllor; etj.
- d) Dokumenti duhet te pershkruaje se çfare avansimi teknologjik dhe çfare kontributi per kompetitet dhe pluralizem mediatik ne treg sollen Televizonet Kabllore.

**NOTE:** Insistojme qe ne dokument, kur flitet per OSHP ne kohen e transmetimit analog, perkufizimi Ofrues i Sherbimeve Programore te ndryshohet me perkufizimin "Televizion Kabllor", sepse ne si themelues gjithe kesaj kohe e kemi toleru kete deminutiv si OSHP, duke shpresuar se me procesin e digitalizimit KPM do t'i permiresoje dhe saktesoje perkufizimet, rregulloret dhe shkresat e saj, duke i barazuar ne perkufizim dhe trajtim akteret e tregut, dhe duke u liruar nga ky diskrimin aspak i nevojshem per kredibilitetin e KPM.

3.

Faqe 12, "**Transmetimi në rrjetet IPTV dhe platformën satelitore**"

*"Në Kosovë operojnë edhe operatorë të cilët bëjnë shpërndarjen e programeve televizive përmes IP (Internet Protocol Television / IPTV). Nuk ka transmetues satelitor të Kosovës i cili transmeton programin e vet vetëm në satelit."*

KOMENT: Pjesa qe i kushtohet IPTV'se dhe Televizionit satelitor pershkruhet vetem me dy fjali (sic!). Per ta kuptuar se sa i rendesishem eshte transmetimi me satelit e me IPTV, mjafton te sjellim ne mend oferten e DIGITALB qe ofrohet përmes satelitit. Kjo pako me programe vertet shtoi oferten televizive, por destabilizoi tregun mediatik ne Kosove, e kompromitoi rolin e KPM si rregullator sepse demaskoi paaftesine dhe papregaditjen ligjore te KPM per t'u ballafaquar me sfidat qe sjell avansimi teknologjik, dhe instaloi permbajtje programore qe nuk i referohen rregulloreve dhe akteve nenligjore te KPM. Dokumenti ne kete pjese i ka - vetem dy fjali.

SUGJEROJME:

- a) Me 500 fjalë te sjellet historia e transmetimit satelitor ne Kosove. (Domethenia e transmetimit satelitor per Kosoven eshte e paçmim, sepse ne kohen e apartheidit te viteve 90'te, ishte kjo forme e transmetimit qe informoi popullaten përmes Programit Satelitor te Televizionit te Prishtines, qe shkaku i rrrethanave transmetohej nga Tirana. Le te ju kujtohen 'saqat'!);
- b) Te analizohet shembuli i DigitAlbit, i cili përmes transmetimit satelitor i beri *by pass* legjislacionit dhe 'kufijve' imaginare te Kosoves;
- c) Te konstatohet saktesisht se ne cilat nene dhe ne cilat pika te legislatures pozitive ne Kosove Digitalb ka bere shkelje;
- c) Te analizohet pse transmetimi satelitor nuk po gjen teren ne Kosove, krahasu me format tjera te transmetimit te sinjalit;
- d) Te spjegohet: Ku humben dhe pse humben saqat?;
- dh) Te potencohet domethenia, risite qe sjell, e sotmja dhe e ardhmja e IPTV.

4.

Faqe 21, **Shërbimet mediale audio-vizuele regionale dhe lokale**

*"Gjatë kalimit në transmetim digital, KPM-ja do të inkurajojë shërbimet mediale audio-vizuale regionale dhe ato lokale, që të krijojnë identitetin e tyre duke kultivuar përbajtjet programore të cilat trajtonë problemet e rajoneve të caktuara apo bashkësive lokale në të cilat ato veprojnë."*

**KOMENT:** Jo me pak se televizionet kabllore kane vuajt televizionet lokale dhe regionale te Kosoves nga asimetria dhe qasja e disekuilibruar e KPM. Aspak te asistuar e te keshilluar, te mbrojtur e te ndihmuar nuk kane qene gjate gjithe kesaj kohe televizionet lokale te Kosoves. KPM nuk kishte arritur qe ta perkufizonte sakt domenin e tyre, burimet e tyre te te ardhurave, t'i mbronte nga 'kulshedrat nationale' qe e hanin edhe centin e fundit te marketingut te tyne, ta ruante pamvaresine e tyre ne situaten kur keto televizione s'kishin rruge tjeter pos t'i dorezoheshin meshires se autoriteteteve lokale politike.

Dokumenti nuk sjell fakte (e as fiale) te mjaftueshme se ne epoken e digitalizuar ky status i tyre do ndryshoje. 43 fjalet e faqes 21 te dokumentit, nuk jane te mjaftueshme per te fituar pasqyren e sakte - si do veprojne dhe cili do te jetë 'domeni' i tyre ne tregun mediatik te Kosoves.

**SUGJEROJME:** E vleresojme ambicjen e KPM qe t'i inkurajoje televizionet regionale dhe lokale te ndertojne identitetin e tyre, por KPM duhet qe ne dokument te sjelle edhe format dhe mekanizmat e asistimit te ketyre televizioneve. Sugjerojme qe me me shume se 43 fjalet te elaborohet roli i televizioneve lokale dhe regionale ne Kosovën e digitalizuar.

5.

#### Faqe 37, Multiplexat komercial nacional MUX1 dhe MUX2

(...)

"Gjatë periudhës tranzitore në një nga dy MUX-at (në MUX 1) do të aplikohet parimi "must carry" (bartje e obligueshme) për televizionet me mbulueshmëri nationale tokësore të cilat veç janë të licencuara nga KPM-ja për transmetim tokësor analog (kanalet e transmetuesit publik RTK, RTV21 dhe KTV).

Parimi "must carry" do të aplikohet për këto arsyet:

Që publiku të vazhdojë të jetë i informuar nga mediat që i ka përdorur si mjetet kryesore për të pranuar programin televiziv që i dedikohet atij;

Që t'i garantohet publikut të kenë qasje në gjuhën e tyre në lajme nationale/kombëtare, informim, edukim, dhe debate kulturore dhe shoqërore;

Që të ruhet dhe promovohet pluralizmi medial dhe diversiteti kulturor;

Që të përkrahet dhe të ofrohet përbajtja lokale / vendore në mesin e përbajtjeve të reja që do të ofrohen;

Parimi "must carry" do të aplikohet gjatë tërë periudhës transitore deri në "switch off" të transmetimit analog (shkycje të transmetimit analog) përderisa KPM nuk vendos ndryshe;

Parimi "must carry" mund të aplikohet edhe për kanalet tjera të cilat do të vlerësohen se janë me interes për publikun e Kosovës."

**KOMENT:** Edhe ne kete pjese te dokumentit, konstatohet asimetria e trajtimit te aktereve te tregut nga ana e KPM dhe qendrimi preferencial i KPM ndaj RTK, TV21 dhe KTV. Ne Ligjin per KPM, nuk kerkohet ky preferencialitet i organeve udheheqese te KPM ndaj ketyne tre aktereve, nga 100 tjere, te tregut medial ne Kosove. Bile ne Kosove kjo 'perpjekje' e vazhdueshme e KPM qe si ne epoken

analoge, ta barte edhe ne epoken digitale preferencialitetin ndaj ketyre tre aktereve eshte e ndaluar me ligje pozitive (Ligji per Mbrojtjen e Konkurences...). Konstatojme se KPM as nuk heziton, e as nuk perpiqet ta kamufloje kete preferencialitet ndaj tri televizioneve. Arsyetimi qe sjell me fjalite "Që publiku të vazhdojë të jetë i informuar nga mediat që i ka përdorur si mjetet kryesore..", demaskon qendrimin qe KPM as po mundohet fort ta fsheh, se kjo fjali e zbulon KPM si gjykues dhe gjyqtar i shijeve te publikut, si nji institucion anketimi, si tifoz, e jo si institucion rregullimi te tregut dhe aktereve qe kete shije, per te cilen flet dokumenti, e ndertojne.

**SUGJEROJME:** Per ta liruar dokumentin nga kjo qasje asimetrike per te cilen sollem shume fakte deri tash, sugjerojme qe keto paragrafe te ndryshojne:

a) Qe parografi:

"*Gjatë periudhës tranzitore në një nga dy MUX-at (në MUX 1) do të aplikohet parimi "must carry" (bartje e obligueshme) për televizionet me mbulueshmëri nationale tokësore të cilat veç janë të licencuara nga KPM-ja për transmetim tokësor analog (kanalet e transmetuesit publik RTK, RTV21 dhe KTV).*"

te ndryshoje:

**Gjatë periudhës tranzitore në një nga dy MUX-at (në MUX 1) do të aplikohet parimi "must carry" (bartje e obligueshme) për televizionet me mbulueshmëri nationale, me skema te ndertuara programore, me identitetet te ndertuara profesionale, me permabatjet e veta gjeneraliste, qe kane ndikuar ne informimin e opinionit, reflektimin e interesit publik, ne suportimin e dialogut dhe debatit ne Kosove.**

b) Qe arsyetimi i sjellur ne fjaline:

"*Që publiku të vazhdojë të jetë i informuar nga mediat që i ka përdorur si mjetet kryesore për të pranuar programin televiziv që i dedikohet atij;*"

Te ndryshoje:

**Që publiku të vazhdojë të jetë i informuar pa nederprerje;**

c) Qe parografi:

"*Parimi "must carry" mund të aplikohet edhe për kanalet tjera të cilat do të vlerësohen se janë me interes për publikun e Kosovës.*"

Te shlyhet krejt. Arsyetimi: Eshte ky paragraf, njesoj si gjithe pjeset tjera te dokumentit qe cituam dhe veçuam me larte, qe dokumenton qasjen asimetrike dhe diskriminuese qe permban dokumenti i analizuar nga ne. Formulimi qe sugjerojme mendojme se eviton paragjykimin e aktereve qe do jene cilesuar e vleresuar per "must carry".

7.

a) Faqe 39, "KPM do të bëjë ftesën për shprehje interesit në bazë të kritereve si në vijim:

- **Përvoja në transmetim tokësor dhe menaxhim;**

B.F.  
9

- *Lloji i programit i dedikuar për publikun;*
- *Përbajtje programore gjithëpërfshtirëse të interesit qytetar të mbarë Kosovës;*
- *kontributi në identitetin qytetar dhe kombëtar,*
- *Sigurimi i rrjetës me mbulueshmëri nacionale si infrastrukturë transmetuese digitale tokësore SFN sipas standardeve të ITU për parametrat e rrjetit të referencës RN1;*"

KOMENT: Kushti qe dokumenti e sjell per t'u vleresuar ne *beauty context* per fitimin e MUX'it, ashtu si eshte formuluar ne fjaline: "***Përvoja në transmetim tokësor dhe menaxhim***" - vene ne pikepyetje kredibilitetin e shkruesit dhe propozuesit te ketij dokumenti.

Kushti, "pervoja ne transmetim tokesor", asht kusht paragjykyes dhe diskriminues qe bie ndesh me Ligjin per Mbrojtjen e Konkurencës (Neni 4, pika 1, 1.1, 1.2, 1.3), bie ndesh me parimet kushtetuese per mosdiskriminim, sepse perjashton pervojen ne transmetim kabllor, satelitor, e format tjera alternative te trasnmetimit si IPTV dhe telefoni mobile. Dhe, ajo qe eshte me domethenie per KPM eshte se, ky kusht, keshtu si eshte formuluar, bie ndesh me Nenin 6 te Ligjit per KPM qe flet se anetaret e KPM nuk duhet te influencozen nga jashte. E kjo domethene, se KPM nuk duhet te influencozen e diktohet nga televizionet me transmetim tokesor si KTV dhe TV21.

#### SUGJEROJME:

Qe fjalia:

***"Përvoja në transmetim tokësor dhe menaxhim"***

te ndryshoje:

**Pervoje ne transmetime televizive dhe menaxhim.**

b) Sugjerojme qe si kushte per te konkuruar per MUX duhet te jene edhe keto:

- Permbajtja programore te jete ne nivelin 70 perqind reflektim i realitetit dhe temave te Kosoves;
- Permbajtja programore duhet te reflektoje idene, parimet dhe vlerat europiane ne nivelin e 10 perqind te programit.

c) Qe fjalia po ne kete faqe qe prezenton kusht per MUX:

- *"Sigurimi i rrjetës me mbulueshmëri nacionale si infrastrukturë transmetuese digitale tokësore SFN sipas standardeve të ITU për parametrat e rrjetit të referencës RN1;"*

te 'perkthehet' nga kjo terminologji teknike, dhe te spjegohet me gjuhe te kuptueshme.

7.

#### KUANTIFIKIMI:

Dokumenti 7 here permende taksativisht KTV, dhe asnjehere RROKUM ose KLAN KOSOVA. Kjo na ben te mendojme se dokumenti ose eshte i shkruar moti, ose shkruesi nuk e njeh tregun mediatik ne Kosove, ose eshte qorruar nga avokimi qe i ben KTV, TV21 e RTK sa na e len lehte te kuantifikueshem dhe te sankcionueshem (edhe penalisht) kete preferencialitet.

#### PERFUNDIM:

Dokumenti i propozuem ne kete forme, ne pjeset ku sjell perkufizime dhe na jep pasqyren e tregut mediatik , vuen nga gabime materiale, nga perkufizime thelbesisht te gabuara, eshte krejtesisht i shkruar dhe perpiluar ne forme preferenciale, anuese, aspak profesionale, duke e demaskuar shkruesin dhe propozuesin e ketij dokumenti si avokat te tre aktereve ne treg, RTK, KTV, dhe TV21 dhe duke diskriminuar ne forma arrogante, te paargumentuara, joprofesionale akteret tjere te tregut medial ne Kosove. Madje edhe dinjitetin e tyre njerezor!

Dokumenti na jep nje pasqyre te thyer te situates mediale ne Kosove, nuk e pershkruan, e hesht dhe e mungon zhvillimin e madh qe ka pesue tregu medial me Televisionet Kabllore, e redukton krejt strategjine vetem ne çeshtjet qe lidhen me televisionet tradicionale.

Sado qe korniza teknike, karakteristikat dhe standartet teknike jane studiuar dhe perzgjedhur profesionalisht, preferencialiteti, animi dhe avokimi ndaj tre aktereve te tregut e shemb dhe konteston profesionalitetin e shkruesit.

Dokumenti i ofruar ne kete forme, nuk kuptohet a ka per shkrues dhe propozues TV 21 e KTV, apo Komisionin i cili ne titull, lere me ne mision kushtetues dhe ne ligje ka si vokacion e identitet - PAMVARESINE.

I ofruar ne kete forme, shkaku i te gjitha pikave qe sollem si komente ne kete dokument, mendojme se "strategja" vene ne pikepyetje te madhe kredibilitetin dhe profesionalitetin e shkruesit dhe propozuesit.

Nese aprovohet ne kete forme, ky dokument shkele rende jo vetem projektet tona televizive, ligjet pozitive ne Kosove, shkel aktet mbi te cilet eshte ndertuar KPM, po edhe dinjitetin tone njerezor e profesional, dhe po u aprovua pa keto ndryshime qe po i propozojme, kjo na ben qe te marrim masa dhe veprime konkrete juridike ndaj shkruesit dhe propozuesit per te mbrojtur ne radhe te pare - dinjitetin tone njerezor dhe profesional.

Per Televizionin RROKUM

Migjen Kelmendi

Per Klan Kosova

Baton Haxhiu